

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË
NR. 1878 . REP.
NR. 634 . KOL. 15



KONTRATË SHIT-BLERJE
(PËR TRANSFERIMIN E KUOTAVE TË KAPITALIT THEMELTAR)

Sot më dt. 13. 06. 2007 (dymijë e shtate), përpara meje noteres publike Vezire Dushi me seli në lagjen “29 Nentori” Fier u paraqitën personalisht palët e kësaj kontrate të cilat bien dakord si vijon:

SHITËSIT:

- **1-ASLLAN SHAHIN BARAJ** i datëlindjes 11.08.1955 lindur ne Mallakaster dhe banues në Tirane , identifikuar me dok. EV 465598 , madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar; në cilësinë e ortakut të shoqërisë “QERAMIKA E JUGUT “ sh.p.k. me seli në Permet me 33% te kuotave , person juridik, i rregjistruar në rregjistrin tregtar, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr., 6825 dt.24.10.1994, nr. 6825/1 date 26.01.1999 6825/5 date 22.06.2005 dhe ndryshime t e tjera ;
- **2- SHPETIM MUHARREM BEGA** i datëlindjes 16.01.1954 lindur ne Permet dhe banues në Permet , identifikuar me license nr. Z3002/2 , madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar; në cilësinë e ortakut të shoqërisë “QERAMIKA E JUGUT “ sh.p.k. me seli në Permet me 33% te kuotave , person juridik, i rregjistruar në rregjistrin tregtar, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr., 6825 dt.24.10.1994, nr. 6825/1 date 26.01.1999 6825/5 date 22.06.2005
- (në vijim referuar si “SHITËSIT”).

BLERËSI:

1-PERPARIM NJAZI SKENDERI , i datëlindjes 20.04.1944 lindur në Permet dhe banues në Lushnje , identifikuar me lnj.nr.EV 316370 me zotësi të plotë juridike për të vepruar, ortak me 34% e kapitalit ne shoqerine “QERAMIKA E JUGUT “ shpk PERMET (në vijim referuar si “BLERËSI”).

BAZA JURIDIKE E KONTRATËS:

Baza juridike e kësaj kontrate është legjislacioni shqiptar, përkatësisht ligji "Për shoqëritë tregtare", Nr.7638, datë 19/11/1992, neni 45 e vijim.

OBJEKT I KONTRATËS:

Objekt i kësaj kontrate shitjeje, është shitja e kuotave të kapitalit themeltar dhe të drejtave të lidhura me to, në masën e përcaktuar me poshtë, nga ana e shitëssve tek blerësi, e për pasojë kalimi i pronësisë së shoqërisë "QERAMIKA E JUGUT " sh.p.k. tek Blerësi në masën dhe kuotën e përcaktuar në këtë kontratë.

KUSHTET E KONTRATËS

1. Shitësit Asllan Baraj dhe Shpetim Bega dhe blerësi Perparim Skenderi, janë ortakë të shoqërisë " QERAMIKA E JUGUT " sh.p.k Permet, me kapital themeltar 25.000.000 (njetzet e pesemilion) lekë. Ata zotërojnë kuotat e kapitalit themeltar në masën 34 % për ortakun Perparim Skenderi, 33% për ortakun Shpetim Bega dhe 33% për ortakun Asllan Baraj. Shitësit Shpetim Bega dhe Asllan Baraj dhe blerësi Perparim Skenderi nën përgjegjësinë e tyre deklarojnë se, shoqëria "QERAMIKA E JUGUT " sh.p.k. Permet nuk ka detyrime monetare ndaj subjekteve të tretë apo ndonjë institucioni shtetëror prej vitit të krijimit deri ditën e lidhjes së kësaj kontrate.
2. Shitësat i shesin Blerësit përkatësisht:
 - Z.Asllan Baraj, pronar i 33% (TRIDHJETE E TRE për qind) të kuotave të kapitalit themeltar i shet Blerësit, 33% (tridhjetë e tre për qind) të kuotave të kapitalit themeltar, me çmimin 8.250.000 (tetemilion e dyqint e pesedhjetemije) lekë.
 - Z.Shpetim Bega, pronar i 33% (TRIDHJETE E TRE për qind) të kuotave të kapitalit themeltar, i shet Blerësit 33% (tridhjetë e tre për qind) të kuotave të kapitalit themeltar, me çmimin 8.250.000 (tetemilion e dyqint e pesedhjetemije) lekë.
3. Blerësi blen nga Shitësit në total 66% (gjashtedhjetë e gjashtë për qind) të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë tregtare "QERAMIKA E JUGUT " sh.p.k Permet, person juridik, i regjistruar në regjistrin tregtar, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.6825 date 24.10.1994, nr. 6825/1 dte 26.01.1999, nr.6825 date 22.06.2005 dhe modifikimet e tjera.
4. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, blerësi bëhet pronar i vetëm i " QERAMIKA E JUGUT" sh.p.k. Permet në kuotat e kapitalit themeltar dhe të drejtat e lidhura me to si më poshtë vijon:
 - A. Z.PERPARIM SKENDERI, pronar i 100 % (njëqint për qind), të kuotave të kapitalit themeltar:
5. Me nënshkrimin e kësaj kontrate shitjeje, shitësit humbasin çdo të drejtë pronësie mbi pjesët e tyre të kapitalit themeltar të cilat janë transferuar lirisht nga shitësit tek blerësi. Të gjitha të drejtat e pronësisë mbi këto pjesë kapitali (66%) të përcaktuar në kontratë i kalojnë blerësit I cili së bashku me kuotën e tij të kapitali 34 % bëhet pronar i 100% të kuotave të kapitali të shoqërisë.



6. Me nënshkrimin e kësaj kontrate shitjeje, blerësi i paguan shitësave në total çmimin e kontratës prej 16.500. 000 (gjashtembdhjetemilion e peseqintmije) lekë, me pagesë të menjëherëshme e cila është kryer jashtë kesaj zyre noterie.



7. Për të vërtetuar sa më sipër, u hartua prej meje noteres kjo kontratë Shit-Blerje e kuotave të kapitalit e cila pasi u lexua dhe u gjet e shkruar drejt sipas vullnetit të palëve, u nënshkrua prej tyre ne praninë time, sipas ligjit dhe unë noterja e vërtetoj atë rregullisht.

SHITËSIT

BLERËSI

Z.ASLLAN BARAJ

Z.SHPETIM BEGA

PERPARIM SKENDERI

Asllan Baraj
AB

Shpetim Bega
SB

Perparim Skenderi
PS

NOTERIE
VEZIRE DUSHI

[Signature]